



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

SHKOLLA _9-vjecare Marqinet

Nr:236. Prot

Marqinet, më22.04.2015

NJOFTIM PËR KONKURIM PËR VEND TË LIRE PUNE

Shkolla "9-vjecare Marqinet", Tiranë, në zbatim të Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimit Nr.35, datë 30.09.2014 "Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar", shpall njoftimin e kërkesave për konkurim, për vendin e lirë të punës në pozicionin Mësues Edukimi fizik

1. Shkolla "9-vjecare Marqinet", Tiranë. Të gjithë mësuesit e këtij profili (Edukim Fizik), të interesuar për këtë pozicion pune (Mësues ne AMU), duhet të paraqesin pranë drejtorisë së Shkollës "9-vjecare Marqinet", Tiranë, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Diplomë të ciklit të dytë të studimeve universitare, sipas përcaktimeve të nenit 57 të Ligjit Nr.69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", (fotokopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave të shkollës së lartë).

b) CV dhe kopje të dëshmimeve apo dokumente që vërtetojnë pohimet në CV (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën Nr.1, bashkëlidhur Udhëzimit Nr.35, datë 30.09.2014).

c) Tabelën e të dhënave për aplikant (Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën Nr. 2, bashkëlidhur Udhëzimit Nr.35, datë 30.09.2014).

d) Raportin mjeko - ligjor.

e) Dëshminë e masave disiplinore në fuqi në ngarkim të tij. (Nëse nuk ka e deklaron me shkrim që nuk ka).

f) Dëshminë e penaltetit, të lëshuar jo më herët se tre muaj para datës së aplikimit.

Dorëzimi i dokumentacionit të aplikimit për konkurim, do të bëhet pranë drejtorisë së Shkollës "9-vjecare Marqinet", Tiranë, me adresë Rruga "e Stadiumit", çdo ditë nga ora 08:00 – 14:00.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të aplikimit për konkurim, do të jetë data 01.05.2015 ora 14.00. Dokumentacioni për aplikim dorëzohet në drejtorinë e Shkollës "9-vjecare Marqinet", Tiranë, me procesverbal dorëzimi.

DREJTOR

Agim Korriku